

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Kepi Palit WIND" SH.P.K.**

**Kreu I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Selia**

**Neni 1: Data e themelimit, emërtimi dhe themeluesit**

Sot më datë 25/08/2019 Bazuar në "Ligji nr.9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; themelohet shoqëria e quajtur "**Kepi Palit WIND**" shpk nga ortakët themelues si më mëposhtë.

1) - **Shoqëria TOMAY s.r.l.**, me qender legale ne Sofia Bullgari, kodi fiskal dhe numuri i regjistrimit 203686909, perfaqesuar nga administratori i vetem Giuseppe TOMA, si perfaqesues ligjor i ndermarrjes, - në cilësinë e ortakut.

2) - **Shoqëria Nicolardi Architecture & Designe Shpk**, me seli ne Rrugën Ndre Mjeda Residenza Eagle, Nujesia 3009, me NUIS L91902001V përfaqësuar nga Gianfranco NICOLARDI, administrator i vetem, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Pasaporten Nr. YA2087050 ne cilesine e ortakut

3) - **Gentian DËRMISHI**, i biri i Xhevairit, lindur në Elbasan më 04-05-1973, me banim ne adresen Rrugën Nde Mjeda, kompleksi Kontakt, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me ID nr. H30504054U . ne cilesine e ortakut

4) - **Ilir PILKATI** i biri Sabriut, i lindur ne Tiranë me 27-05-1958, me banim ne: Rruga Gjik KUQUALI Ban. 14 Ap. 43 Tiranë, madhor, me zotesi te plote per te vepruar identifikuar me ID nr. F80527041P ne cilesine e ortakut

**Neni 2: Objekti**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të zhvillojë aktivitet me objektin e mëposhtëm:

**1) Studime fisibiliteti projektesh, ndjekje procedurash për paisje me dokumentacionin e nevojshëm dhe licenca, bazuar në legjislacionin kombëtar dhe lokal. Ndertime, instalime, tregetim, blerje, shitje dhe administrim të impianteve për prodhimin e energjisë elektrike si Solar, me erë, me hidro, me biomasë si dhe mirëmbajtje të këtyre impianteve për llogari të të tretëve.**



*II) Prodhim, shpërndarje dhe shitje si në Shqipëri dhe jashtë territorit të Shqipërisë të energjisë elektrike nga burime energjie të rinovueshme, blerje të energjisë të përfituara nga burime të rinovueshme si dhe rishitje, (në respektim të legjislacionit në fuqi) subjekteve si publik dhe privat në Shqipëri dhe jashtë saj.*

*III) Studime, kërkime dhe zhvillim të projekteve të reja teknologjike, të markave dhe patentave industriale dhe zbatimit të tyre. Shitblerje, ndërmjetësime dhe administrime strukturash energjitike*

**Neni 3: Kohëzgjatja**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ka kohëzgjatjen e saj të papërcaktuar.

**Neni 4: Selia e shoqërisë**

Shoqëria do të ketë qendren e saj legale - në adresën: Rruga Ndre MJEDA Residencia Eagle njesia nr.3009.

**Neni 5: Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është 1 000 Lekë (Një mijë lekë)

Ortakët marrin në pronësi kuota të tyre të kapitalit themeltar në përputhje me kontributin e secilit, si vijon:

- 1) - Shoqëria "TOMAY" srl                      Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme, që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2)- Shoqëria "Nicolardi Architecture & Design" Shpk    Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme, që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 3) - Gentian DËRMISHI                      Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme, që përbën 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 4) - Ilir PILKATI                                Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme, që përbën 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pagesat e kontributeve në para bëhen në rrugë bankare në llogarinë e celur pranë Tirana BANK sh.a Kontributi i ortakëve mund të jetë edhe në (pasuri të luajtëshme, të paluajtëshme apo të drejta)



**GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT**  
Nicolardi Architecture & Design SH.P.K.  
NU.S: L91902001V - TIRANE

## Neni 6: Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë janë administratori dhe asamblea e përgjithëshme e ortakëve, që kanë pushtetet e tyre të përcaktuara nga statuti i shoqërisë. Asamblea e përgjithshme emëron në cilësinë e administratorit të shoqërisë, zotin Giuseppe TOMA, për një periudhë (1) një vjecare, në bazë të nenit 81, paragrafi 1, shkronja 3 dhe neni 95, të ligjit, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me **Karten e Identitetit Nr.YA4199152**

Ngarkohet administratori i shoqërisë, të kryejë të gjitha veprimet, anulimet, shtesat, korigjimet dhe përmirësimet e domosdoshme dhe të nevojshme në aktet e shoqërisë, nëse do të kërkohej nga organet përkatëse për regjistrimin e akteve të shoqërisë, me rastin e depozitimit të kërkesës për regjistrim, pranë regjistratit tregëtar. Ai është i autorizuar që në përmbushjen e detyrës së ngarkuar të emërojë avokate ose përfaqësues të tjerë, që ai do t'i konsiderojë të nevojshëm.

## Neni 7: Legjislacioni

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, shoqëria është person juridik shqiptar dhe veprimtaria e saj do të rregullohet, në bazë të këtij Akti Themelimi dhe të Statutit të saj. Për gjithçka të paparashikuar në këtë Akt Themelimi dhe në statutin e shoqërisë, do të zbatohet legjislacioni shqiptar.

Ky akt themelimi është redaktuar në gjashtë ekzemplare origjinale, me të njëjten vlerë juridike.

Lexuar, aprovuar, nënshkruar

ORTAKËT THEMELUESA

1) Shoqëria "TOMAY" s.r.l.

2) Shoqëria "Nicolardi Architecture & Design" shpk

3) Gentian Dërmishi

4) Ilir PILKATI



  
**GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT**  
Nicolardi Architecture & Design SH.P.K.  
NUI5: L91902001V - TIRANE

**STATUTI**  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Kepi Palit WIND" SH.P.K.

**Titulli I**

**Themelimi, emërtimi, objekti, kohëzgjatja, selia**

**Neni 1: Data e themelimit, emërtimi**

(1) Sot, në Tiranë, më datën 25-08-2019, ne, ortakët themeluesë kemi themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "Kepi Palit WIND" sh.p.k.

(2) Ortakët themeluesë janë:

1) - Shoqëria "TOMAY" s.r.l., me qendër legale në Sofje, Bullgari, kodë fiskal dhe numuri i regjistrimit Nr.203686909, përfaqësuar nga administratori i vetëm Giuseppe TOMA, si përfaqësues ligjor i ndërmarrjes, - në cilësinë e ortakut.

2) - Shoqëria "Nicolardi Architecture & Design" Shpk, me seli në Rrugën Ndër Mjeda Residenza Eagle, Nr 3009, me NUIS L91902001V përfaqësuar nga Gianfranco NICOLARDI, administrator i vetëm, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Pasaportën Nr. YA 2087050; në cilësinë e ortakut

3) - Gentian DËRMISHI, lindur më 04-05-1973, me banim në adresën Rrugën Ndër Mjeda madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me ID nr. H30504054U në cilësinë e ortakut.

4) - Ilir PILKATI i biri Sabriut, i lindur në Tiranë më 27-05-1958, me banim në adresën: Rruga Gjith KUQUALI Ban. 14 Ap. 43 Tiranë me Nr. ID nr. F80527041P madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, në cilësinë e ortakut



## Neni 2: Objekti

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të zhvillojë aktivitetet me objektin e mëposhtëm:

**I) Studime fisibiliteti projektesh, ndjekje procedurash për paisje me dokumentacionin e nevojshëm dhe licenca, bazuar në legjislacionin kombëtar dhe lokal. Ndertime, instalime, tregetim, blerje, shitje dhe administrim të implanteve për prodhimin e energjisë elektrike si solar, me erë, me hidro, me biomasë si dhe mirëmbajtje të këtyre implanteve për llogari të të tretëve.**

**II) Prodhim, shpërndarje dhe shitje si në Shqipëri dhe jashtë territorit të Shqipërisë të energjisë elektrike nga burime energjie të rinovueshme, blerje të energjisë të përfituara nga burime të rinovueshme si dhe rishitje, (në respektim të legjislacionit në fuqi) subjekteve si publik dhe privat në Shqipëri dhe jashtë saj.**

**III) Studime kërkime dhe zhvillim të projekteve të reja teknologjike, të markave dhe patentave industriale dhe zbatimit të tyre. Shitblerje, ndërmjetësime dhe administrime strukturash energjitike**

## Neni 3: Selia e shoqërisë

Shoqëria do të ketë qendren e saj ligjore në adresën: Rruga Ndërc MJEDA Residencia Eagle njesia nr.3009.

Shoqëria mund të ngrejë edhe qendra të tjera sekondare, filiale, degë, zyra përfaqësimi e agjensi dhe në rrethë të tjera të vendit ose jashtë tij.

## Neni 4: Kohëzgjatja

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ka kohëzgjatjen e saj të papercaktuar.

  
**GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT**  
Nicolardi Architecture & Design S.H.P.K.  
NUIS: IL91902001V - TIRANE



## Titulli II

### Kapitali themeltar

#### Neni 5: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është baraz me shumën 1 000 Lekë (Një mijë lekë)

Ortakët marrin në pronësi kuota e tyre të kapitalit themeltar në përputhje me kontributin e secilit, si vijon:

- 1) - Shoqëria "TOMAY" srl                      Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme, që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) - Shoqëria "Nicolardi Architecture & Design" Shpk                      Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme, që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 3) - Gentiam DËRMISHI                      Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme, që përbën 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 4) - Ilir PILKATI                      Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme, që përbën 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit themeltar dhe tërheqja e kuotave të papaguara.

(1) Administratori mund të kërkojë ortakëve derdhjen e shumave të kuotave të nenshkruara prej tyre, në varësi të marrjes së një njoftimi prej, të paktën, katërmbëdhjetë ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa. Ortaku i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e vera, siç përcaktohet në njoftim. Thirrja për pagesë mund të kërkojë që pagesa të bëhet me këste. Personi, të cilit i drejtohet thirrja për pagesën e kontributit, përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së kuotave, me të cilat lidhet thirrja për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote mbajnë përgjegjësi solidarisht për të shlyer të gjitha thirrjet për pagesë të kontributit, të cilat lidhen me këtë kuotë.

(3) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e paslyer në fund të afatit të vet, personi, të cilit i drejtohet thirrja dhe që është përgjegjës për pagesën, paguan një interes mbi shumën e papaguar, duke filluar nga dita kur mbaron afati, deri në momentin e pagimit, me një normë vjetore interesi prej kater (4) përqind.

(4) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, administratorët mund t'i japin një njoftim personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar, së bashku me interesat që mund të jetë maturuar, brenda një afati prej katërmbëdhjetë ditësh të plota. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se, nëse nuk zbatohet, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi konsiderohen të anuluar.



GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT  
Nicolardi Architecture & Design S.H.P.K.  
NUIIS: L91902001V - TIRANE

(5) Nëse njoftimi nuk zbatohet, kuota me të cilën lidhet njoftimi, mund të tërhiqet me vendim të administratorëve dhe, tërheqja përfshin edhe të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme, në lidhje me kuotat e tërhequra dhe të papaguara deri në momentin e tërheqjes.

(6) Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e tërhequr mund të shitet, të rishpërndahet ose të tërhiqet, në bazë të kushteve dhe mënyrës që konsiderojnë të arsyeshme administratorët.

(7) Personi, prej të cilit janë tërhequr kuotat e kapitalit, pushon së qeni ortak në lidhje me kuotat e tërhequra, por vazhdon të jetë përgjegjës përpara shoqërisë për të gjitha kontributet, të cilat janë të pashlyera në datën e tërheqjes së kuotave, në lidhje me këto kuota, së bashku me interesin e llogaritur me normën e interesit të zbatueshëm për këto kontribute përpara tërheqjes.

#### **Neni 7: Kuotat, të drejtat dhe kufizimet**

Në varësi të dispozitave të ligjit dhe pa cenuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla, sikunder përcaktohet në vendimin e kualifikuar (me tri të katërtat e votës) të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me Nenin 87.

Ortakët e shoqërisë nuk mundën, as edhe nepermjet nje personi tjetër, te jene ortakë te shoqerive qe ushtrojne veprimtari tregëtare konkurruese me shoqerine ose te kene marrëdhënie te punesimit ose te bashkepunimit me te. Ortakët janë në dijeni të këtij fakti, që një ndalim i tillë shtrihet për periudhën maksimale të kohës të parashikuar nga ligji, duke filluar nga momenti kur ata humbasin cilësinë e ortakut.

#### **Neni 8: Certifikatat e kuotave të kapitalit**

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e certifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët, sipas nenit 72, paragrafi (2) të Ligjit, përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët renditen në certifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e një titulli të kredise.


#### **Neni 9: Kalimi i kuotave me kontratë**

(1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga administratorët. Kalimi i kuotës i njoftohet selisë së regjistruar të shoqërisë.

(2) Administratorët mund të mos pranojnë t'a regjistrojë kalimin e kuotës pranë QKR-së, nëse kuota nuk është shlyer tërësisht ose nëse nuk janë dakord që kuotën ta marrë personi që pretendon ta përfitojë atë.

(3) Nëse Administratorët nuk pranojnë ta regjistrojë kalimin e kuotës, ata, brenda një muaji pas datës, në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë marrësit njoftimin për mospranimin.

  
**GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT**  
Nicolardi Architecture & Design SH.P.K.  
NUIB: 1919028019 - TIRANË



#### **Neni 10: Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit**

(1) Nëse një ortak vdes, trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona, të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës të tij; asnjë dispozitë e këtij statuti nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia, në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.

(2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë, si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotëruesi i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotëruesi vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotëruesi i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon instrumentin e kalimit të kuotës të ky person tjetër.

(3) Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë, si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, gëzon të drejtat, titullar i të cilave do të kishte qenë si zotëruesi i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblesë e shoqërisë.

#### **Neni 11: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

(1) Asambleja e Përgjithshme mund ta zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. I njëjti vendim i kualifikuar kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

(2) Me anë të një vendimi të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet.

#### **Neni 12: Blerja e kuotave nga vetë shoqëria**

Shoqëria mund t'i blejë kuotat e veta dhe të bëjë një pagesë në lidhje me blerjen e kuotave të veta, jo nga fitimi për t'u shpërndarë i shoqërisë dhe as nga mjetet monetare të siguruara nga një emetim i ri kuotash, vetëm nëse shoqëria i plotëson kushtet për shpërndarjen të parashikuar në nenin 77 të Ligjit dhe administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, të kërkuar nga ky nen. Nëse blerja e kuotave të veta nga shoqëria nuk i përmbush kushtet e nenit 77, mund të ngrihet padi në emër të shoqërisë, në përputhje me nenet 78 dhe 79.

### **Titulli III**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

#### **Neni 13: Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

(1) Administratori mund të thërrase mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, kur ta mendojnë të arsyeshme vetë dhe duhet ta thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë ta kërkojnë ortakët, në përputhje me nenin 84 të Ligjit. Asambleja mund të thirret prane selisë së saj ose në cdo vend tjetër, në Shqipëri ose edhe jashtë saj.

**GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT**  
Nicolardi Architecture & Design SH.P.K.  
NUI: L91902001V - TIRANE





(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike, që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të bëhet të paktën shtatë ditë të plota pune përpara mbledhjes. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i për të mundur pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.

(3) Mosveprimi i paqëllimtë për dhënien e njoftimit për mbledhjen ose mosmarrja e njoftimit për mbledhjen, nga personat që kanë të drejtën për ta marrë një njoftim të tillë, i bën të pavlefshme punimet e mbledhjes, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

(4) Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblese se përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem, sipas rregullit të përcaktuar në nenin 81, pika 3, të ligjit.

#### **Neni 14: Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

(1) Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të fillojnë, nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në nenin 86 të ligjit. Ortakët ose zotëruesit e prokurave të votimit mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas nenit 88. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë, pasi të paraqesin PIN-in që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Administratori cakton një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur proces - verbalin e mbledhjes.

(3) Nëse Administratori nuk ka dëshirë të jetë Kryetari i mbledhjes nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta, duke filluar nga ora e vendosur për të mbajtur mbledhjen, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen, si Kryetar i saj.

(4) Pavarësisht, nëse është ose jo ortak, Administratorit i lejohe të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Me pëlqimin e mbledhjes, në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhje të shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë problem me përjashtim të atyre të parashikuara në rendin e dites. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditë të plota, në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e problemeve të parashikuara në rendin e dites. Përndryshe, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i vlefshëm.

(6) Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë:

1. Kryetari ose

2. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se pesë përqind të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.

  
**GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT**  
Nicolardi Architecture & Design SH.P.K.  
NUIIS: L91902001V - TIRANE

 9

(7) Nëse deklarata e bere nga kryetari nuk eshte kundërshtuar, se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe është bere regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e asamblese, ky deklarim do te konsiderohet i diskutueshem, pa pasur nevojë për provën e numurit ose te përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8) Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

#### **Neni 15: Votat e ortakëve**

(1) Në varësi të të drejtave ose te kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortakut, i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi, ka të drejtën e një vote.

(2) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij, në lidhje me kuotën në fjalë.

(3) Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit. Në rast te kundert, vendimi i tij është i pakundërshtueshem.

#### **Neni 16: Votimi me prokurë**

(1) Ortaku e lëshon prokurën, sipas formës me te pershtateshme te mundur, me kusht qe te shprehet qarte vullneti i te perfaqesuarit.

(2) Prokura me shkrim ose një kopje e noterizuar ose e aprovuar nga Administratorët mund të depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sikurse përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues votimi të dërguar nga shoqëria, në lidhje me mbledhjen e Asamblesë.

#### **Neni 17: Hetimet e posaçme**

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posaçëm, sipas nenit 91 të ligjit, e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e shoqërisë të një dokumenti, së bashku me një deklaratë notriale, e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

#### **Neni 18. Kompetencat ligjore per veprimet me banken**

Te gjitha veprimet me bankat do te kryhen nga z.Giuseppe TOMA pra do te ketë i vetëm, te drejte per te firmosur si administrator i shoqërisë.

**GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT**  
Nicolardi Architecture & Design SH.P.K.  
NUI: L9190200LV - TIRANE



## Titulli IV

### Administratori

#### Neni 19: Emërimi i administratorëve

(1) Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator/e të shoqërisë për një vit, sipas nenit 81 paragrafi (1), shkronja c) dhe nenit 95 të ligjit. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi të zakonshëm, i cili, nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.

(2) Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në nenin 95, paragrafi (2) të Ligjit.

(3) **Administratori** i vetëm i parë i shoqërisë caktohet zoti **Giuseppe TOMA**, me një afat kohor prej një viti, me zotesi të plote për të vepruar,

#### Neni 20: Kompetencat e Administratorit

Veprimtaria tregtare e shoqërisë drejtohet nga Administratori, i cili ushtron të gjitha kompetencat e ngarkuara, në bazë të kërkesave të parashikuara nga nenet 95, 96, 97 e 98 dhe dispozitave të tjera, të parashikuara nga ky ligj.

Administratorit i njihen pushtetet vijuese për çeshtjet këtu të përcaktuara, të cilat ai mund t'i ush-troje me firmën e vet personale:

- 1) Të firmose të gjithë korrrespondencën e perditeshme të shoqërisë edhe pse me karakter konfi-dencial ose të rezervuar, duke vendosur përpara emrit të tij emrin e shoqërisë, me firme të ndare;
- 2) Të hartojë kontratat e nevojshme me qëllim administrimin e zakonshëm të shoqërisë dhe të beje ç'ka është e nevojshme për ekzekutimin e tyre;
- 3) Të shkëmbejë pasuri materiale, përfshirë automjetet dhe të përmbushë formalitetet e rastit pranë zyrave publike ( përfshirë këtu edhe Regjistrimin Publik Automobilitik);
- 4) Të nënshkruajë kontratat e nevojshme për administrimin efikas të zyrave të shoqërisë, si për shembull marrjen me qera të lokaleve, të prokurorje shtëmbime, etj.;
- 5) Të punësojë, të pezullojë ose të pushojë punëtorë dhe nëpunës të çdo kategorie, duke përjashtuar drejtuesit, duke fiksuar ose modifikuar pagat, shpërblimet, rrogat, likuidimet për largim nga puna ose të tjera të kësaj natyre;
- 6) Të nënshkruajë kontrata të çfarëdo lloji me banka ose me organizma finansiare, dhe në lidhje me këto, të hapë llogari rrjedhese e të kryejë veprime me këto llogari;
- 7) Të leshojë dhe firmose ceqe në emër të shoqërisë, jo nga llogari të zbuluara, të arketojë ceqe të çfarëdo lloji, të leshojë vertetime mbi marrjen e tyre;
- 8) Të marrë dhe të kërkojë pagesat e çfarëdo lloji shumë që i përket shoqërisë nga cilido subjekt ose firmë dhe të leshojë vertetim mbi marrjen e tyre;
- 9) Të përfaqësojë shoqërinë në të gjithë marrëdhëniet me institutet siguruese dhe të asistencës;

GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT  
Nicolardi Architecture & Design S.H.P.K.  
NUI: 191902001V TIRANE



*Handwritten signature in black ink.*

*Handwritten signature in blue ink.*

- 10) Te emetoje, te pranoje, te hyje ne bisedime, te aplikoje ulje, te xhiroje, te jape garanci kambiale, te leshoje dokumente per marrje te pagesave te kryera dhe, ne pergjithesi, te nenshkruaje, ne emer te shoqerise, kambiale, premtime pagese dhe cfaredo lloj titulli me natyre te njejte edhe ne favor te te treteve, te cilet nuk jane bankare;
- 11) Te terheqe nga zyrat postare dhe telegrafike letra te zakonshme, urgjente ose te siguruara, pagesa postare dhe telegrafike, pliko dhe pako, te mira te cfaredo lloj natyre, duke nenshkruar marrjet e tyre, aktet e terheqjes, perjashtimin nga pergjegjesite, te hape llogari rrjedhese postare dhe te kryeje operacione mbi te njejtat dhe te nenshkruaje marreveshje te cfaredo lloj natyre, edhe financiare me zyrat postare.
- 12) Te kerkoje dhe te terheqe letra, dokumente, mallra, para, pliko, pako, te mira te cfaredo lloji nga ndermarrje transportuese ose derguese, zyra doganore, hekurudha publike dhe private, magazina publike dhe private dhe vende depozitimi te tjera, zyra publike te cfaredo lloji; te firmose vertetime per marrje, aktet e terheqjes dhe te lirimit nga pergjegjesite;
- 13) Te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha marredheniet e saj me zyrat publike, entet publike, dhe ne pergjithesi, me te gjitha ata, te cilet kryejne detyra per Shtetin, ashtu si entet lokale dhe Dhomat e Tregetise, dhe ne vecanti, por pa qene taksative listimi;
- 14) Te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha raportet me zyrat financiare me fuqine per te bere marreveshje mbi te ardhurat, te filloje dhe te ushtroje paci perpara cdo autoriteti administrativ, ne komisionet tatimore, autoritetet gjyqesore te Republikes, te redaktoje denoncime, rekurse dhe kundershkrimi kunder cdo vendimi te ketyre zyrave dhe organeve, duke nenshkruar dokumentet perkatese;
- 15) Te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha marredheniet me Banken e Shqiperise, me Zyren e Borxhit Publik, duke kerkuar dhe terhequr para, tituj dhe dokumente te cfaredo lloji; duke firmosur vertetimet per marrje; ashtu si aktet e terheqjes dhe te perjashtimit nga pergjegjesia, te kryeje cdo bise-dim ose veprim me keta organizma;
- 16) Te perfaqesoje shoqerine ne padite dhe procedurat e te gjitha llojeve perpara autoriteteve gjyqesore te Republikes se Shqiperise dhe te vendeve te huaja, te emeroje avokate dhe perfaqesues ne mosmarreveshje gjyqesore;
- 17) Te perfaqesoje shoqerine ne falimentim dhe ne procedurat e falimentimit, te nenshkruajne kontrata me kreditorët dhe, ne pergjithesi, te beje cfare eshte e nevojeshme, ne lidhje me keto procedura;
- 18) Te arrije zgjidhje me marreveshje te shoqerise me te tretet, te nenshkruane kompromise dhe klauzola per zgjidhjen e mosmarreveshjeve nepermjet arbitrazhit, te nenshkruaje marreveshje per zgjidhjen me mirekuptim dhe te firmose dokumentet perkatese persa sipër;
- 19) Te nenshkruaje kontrata me shoqeri ose institute sigurimesh, duke firmosur policat perkatese, me fakultetin per te zhvilluar cdo praktike qe ka te beje me to, dhe te arrije marreveshje, ne rast te verifikimit te rastit faktor, per likuidimin e demeve ose demshperblimeve;
- 20) Te firmosin deklaratat e te ardhurave te cfaredo lloj natyre dhe te kryeje praktikat ne lidhje me to;
- 21) Te firmose deklarimet periodike dhe vjetore me qellim TVSH-je.

Administratori i shoqerise nuk do te mund te permbushe aktet ne vijim, pa autorizimin paraprak te shkruar te asamblese:

  
**GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT**  
 Nicolardi Architecture & Design S.R.L.  
 NUIS: L91902001V - TIRANE



*Ge J*

*[Handwritten signature]*

- a) Te nenshkruaje kontrata te cfaredo lloj natyre, kostoja e se ciles, ose impenjimi ne afatin vjetor per shoqerine, per nje objekt te cfaredo lloji, per nje shume me te madhe se Lek 700.000,00 (shtate qind mije);
- b) Te nenshkruaje cfaredo lloj kontrate qeraje ose te natyre tjeter, ne lidhje me transferimin ose rritjen e hapësirës së lokaleve të shoqërisë;
- c) Te nenshkruaje kontrata, marreveshje dhe impenjime, qe kane te bejne me blerje dhe shitje te aktiveve te pagendrueshme. Per sa i perket kerij perjashtimi, nenkuptohen te perfshira edhe impenjimet per dhënie te qcrase financiare, blerje me keste ose blerje me kredi;
- d) Te punesoje cdo lloj nepunesi ose te rrise shperblimet e tyre, pervec kur kjo eshte shprehur qarte ne buxhetin vjetor, te aprovuar paraprakisht nga organi administrativ;
- e) Te rrise ose modifikojë cfaredo lloj perfitimi, per punetoret, per pensione shtese, sigurime mbi jeten ose semundjen dhe leje ndermarrje te dhena punetoreve ne pergjithesi;
- f) Te delegojë edhe pjeserisht ose te zevendesohet ne ushtrimin e fuqive qe i jane dhene ne cilesite e Administratorit;
- g) Te nenshkruaje kontrata sigurimesh te ndryshme nga ato qe duhen ose jane te nevojshme per zhvillimin normal te veprimtarisë së shoqërisë;
- h) Te lejojë ose te marre cfaredo lloj impenjimi, hipoteke, peng ose garanzi ose cdo kufizim tjeter mbi disponibilitetin e nje pjese ose te te gjithe ndermarrjesi, te pronesise, te te drejtave ose te ve-primtarive, materiale ose jo te shoqerise ose te shoqerive prej saj te kontrolluara;
- i) Te marre ne forme borxhi cfaredo lloj shume;
- l) T'i jape cdo personi ose subjekti cdo lloj huaje ose te jape kredi te ndryshme nga ato qe rrjedhin nga veprimtaria normale e ndermarrjes;
- m) Te jape garanci ose kolaterale personave te trete ose subjekteve te cfaredo lloj natyre;
- n) Te shese, transferoje, jape me qera, te caktojë ose disponojë ne cfardo lloj forme tjeter qofte edhe te nje pjese te vogel te ndermarrjes, te te drejtave dhe veprimtarive, materiale ose jo te shoqerise ose te shoqerive nga ajo te kontrolluara;
- o) Te krijojë, te blejë ose te disponojë cfaredo lloj shoqërie pjesemarrëse ose te aksioneve ne cdo lloj shoqërie;
- p) Te krijojë partnership, joint venture, shoqata me pjesëmarrje me cfardo lloj personi ose subjekti;
- q) Te bëjë ose te lejojë ose te tolerojë qe shoqëria te likuidohet (qofte vullnetarisht ashtu dhe ligjrisht);
- r) Blejë, marre ose nenshkruaje cfaredo lloj aksioni, obligacion ose titull te pasurive te paluajtshme ose cfaredo lloj interesi ne nje shoqëri tjeter, trust ose subjekt tjeter;
- s) Administratori i deleguar nuk do te mund te kryej operacione te cfardo lloj natyre ose teresie, mardje as shitje, jashte territorit te Shqiperise, te Kosoves dhe te Malit te Zi, duke mbajtur parasysh aftesite e kufizuara strukturore logjistike dhe te teknologjise.

Neni 20: Shkarkimi nga detyra e administratorit

  
**GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT**  
 Nicolardi Architecture & Design SH.P.K.  
 NUIS: 191902001V - TIRANE





(1) Shkarkimi i administratorit mund të ndodhë për shkakët e mëposhteme:

1. kur shoqëria deklarohet në likuidim ose në falimentim;
2. vuan nga shregullime mendore ose sëmundje të tjera që e bëjnë të pazot për të ushtruar detyrën e administratorit;
3. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë; ose
4. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e administratorëve të tjerë në mbledhjet e administratorëve, të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të administratorëve të tjerë, vendos t'ia liroje nga detyra. Në rastin e administratorit të vetëm, ko-ha për t'u larguar nga shoqëria nuk mund të jetë më shumë se një muaj.
5. në të gjitha rastet e tjera, të parashikuara nga ligji.

## **Neni 21: Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorit**

(1) Administratori kanë drejtë të marrin shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë në përputhje me nenin 97 të Ligjit.

(2) Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime, në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata persona, të cilët kanë punuar më parë për shoqërinë ose për shoqëri të tjera, të cilat janë ose kanë qenë filiale të shoqërisë ose për shoqëri pararendëse të shoqërisë, ose për familjarë të tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish bashkëshortin ose ish-bashkëshorten) ose për persona të cilët janë në varësi të tyre, dhe mund të japë kontribute në fonde të caktuara për dhënie të përfitimeve të tilla (si përpara ashtu edhe pasi personi në fjalë pushon së mbajturi vendin ose marrëdhënien e punës).

(3) Administratorit ose bashkepunetoreve të tij u paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit ose shpenzime të tjera, që atyre u perkasin për pjesëmarrjen në mbledhjet e administratorëve ose të komiteteve të administratorëve ose në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme ose, në mbledhjet të veçanta të asamblese së ortakeve, si edhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre.

## **Neni 22: Punimet e mbledhjeve të Administratorit**

(1) Mbledhjet e Administratorëve mbahen aq herë sa të konsiderohen të nevojshme.

(2) Kuorumi i nevojshëm për të filluar punimet mbledhjet e administratorëve mund të vendoset prej tyre dhe, nëse nuk vendoset prej tyre, atëherë ky kuorum është dy.

(3) Asambleja e Përgjithshme ngarkon njërin prej administratorëve me detyrën e Kryetarit të mbledhjeve të Administratorëve, duke ruajtur të drejtën për ta shkarkuar nga kjo detyrë në çdo kohë. Kryetari drejton punimet e çdo mbledhje të administratorëve, në të cilat është i pranishëm. Por, nëse Kryetari nuk ka dëshirë të drejtojë punimet e mbledhjes ose nëse nuk është i pranishëm për pesë minuta, duke filluar nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratorët e pranishëm mund të caktojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(4) Vendimet për çështjet që lindin në një mbledhje merren me shumicë votash. Nëse numri i votave është i barabartë, vota e Kryetarit ka përparësi.

### **Neni 23: Kufizimet për votimin**

(1) Një administrator nuk mund të lidhe marrëveshje dhe nuk voton në një mbledhje të Administratorëve për vendime që kanë lidhje me një çështje, në të cilën ai ka, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes material ose moral dhe që bie ose mund të bjerë ndesh me interesat e shoqërisë, sipas nenit 13 të ligjit, nëse të gjithë anëtarët e një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme nuk kanë rënë dakord:

1. të autorizojnë lidhjen e marrëveshjes nga ana e tij dhe
2. ta autorizojnë të votojë për çështjen në fjalë.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të veçantë. Çdo aprovim i përgjithshëm duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Një administrator nuk konsiderohet si pjesëtar i kuorumit të pranishëm në një mbledhje në lidhje me një vendim, për të cilin nuk ka të drejtë vote. Për përjashtimin e administratorit nga marrja e vendimit në një mbledhje të tillë zbatohet përkatësisht neni 89 i ligjit.

(3) Nëse në një mbledhje të administratorëve lind një çështje, për sa i takon të drejtës së një administratori për të votuar, çështja mund t'i kalohet, përpara mbylljes së mbledhjes, Kryetarit të mbledhjes, vendimi i të cilit për të gjithë administratorët me përjashtim të vetes së tij, konsiderohet i formës së prerë.

### **Neni 24: Procesverbalet e mbledhjeve të Administratorit**

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet:

1. e të gjitha takimeve të bëra nga administratorit; dhe
2. e të gjitha punimeve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe mbledhjeve të administratorit dhe të komiteteve të administratorëve, përfshirë edhe emrat e administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

## **Titulli V**

### **Dividendët dhe kapitalizimi i fitimeve**



Handwritten signature and the number 15.

## Neni 25: Dividendët

- (1) Pas përmbushjes së kërkesave të nenit 77 të ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividendë në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (2) Me përjashtim të rasteve, kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u perkasin kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje, me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje, me të cilat paguhet dividendi.
- (3) Dividendet dhe mjetet monetare të pagueshme, në lidhje me një kuotë, nuk mund të fitojnë interesa nga shoqëria, nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i perkasin kuotës.
- (4) Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve, nga data kur konsiderohet i kërkuar, kur Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë atë.

## Neni 26: Kapitalizimi i fitimeve

Me autoritetin që u jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga neni 14 i Ligjit, Administratorët mund të vendosin të kapitalizojnë fitimet e pashpërndara të shoqërisë që nuk kërkohen për të paguar dividendë preferencialë.

## Titulli VI

### Prishja dhe njoftimet

## Neni 27: Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

## Neni 28. Njoftimet

- (1) Njoftimet që u jepen personave ose që bëjnë personat, sipas ligjit ose Statutit, duhet të jenë me shkrim.

  
GIANFRANCO NICOLARDI ARCHITECT  
Nicolardi Architecture & Design SH.P.K.  
NUIJ: L91902001V - TIRANE



  
16



Ky Statut është redaktuar në gjashtë ekzemplare origjinale, me të njëjten vlerë juridike.

Lexuar, Aprovuar dhe Nenshkruar:

ORTAKET THEMELUESA

1) Shoqëria "TOMAY" s.r.l.



2) Shoqëria "Nicolardi Architecture & Design" Shpk.



3) Gentian DËRMISHI

4) Ilir PILKATI